



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:257719  
Datë: 24.02.2025  
Numri i dokumentit: 06893867

**C.nr.4264/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Shaban Shala, me bashkëpunëtorin profesional Y.K. në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.B.M. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës M.A.Sh.T. në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Prishtinë, me objekt kontesti kompensmin e inflacionit në pagë, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 11.02.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**(Pa shqyrtim kryesor)**

**I.APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.B.M. nga Prizreni me objekt kontesti kompensmin e inflacionit në pagë.

**II.DETYROHET** e paditura M.A.Sh.T. në Prishtinë, që paditëses D.B.M. në emër të pagesës kompensmin e inflacionit në pagë, t'ua kompensojë shumën prej 248.11 euro, për periudhën kohore 01.07.2022 - 20.11.2022, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (13.11.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

**III.DETYROHET** e paditura, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve t'ua paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja D.B.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 13.11.2023, përmes të autorizuarit të saj av. A.H. nga Prishtina, ka ushtruar padi kundër të paditurës M.A.Sh.T. në Prishtinë të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Prishtinë, duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.07.2022 deri më datën 20.11.2022, duke theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune pranë Qendrës së Kompetencës në Prizren, dhe bazuar në nenin 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë.

Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore 01.07.2022 deri më datën 20.11.2022, paditëses i takon shuma në lartësi prej 265.64 euro.

Po ashtu, ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Me parashtrësën e datës 26.01.2024, paditësja përmes të autorizuarit të saj ka bërë precizimin e padisë dhe ka kërkuar që në aspektin objektiv vlera e kompensimit të inflacioni të llogaritet duke u bazuar në listën e pagave që rezulton se paditësja pagën bazë e ka në vlerë 459.00 euro, ashtu që për periudhën kohore nga data 01.07.2022 deri me datë 20.11.2022 paditëses të takoj shumë në lartësi prej 248.11 euro.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ku është theksuar se padia e paditëses është mbështetur në Kontratën Kolektive e Arsimit 2017, e paditura vlerëson se asnjë dispozitë ligjore e kësaj kontrate nuk parasheh veprim retroaktiv për realizimin e kësaj të drejte gjegjësisht kompensimin e inflacionit në pagë. Paditësja nuk ka dëshmuar me kontrata të punës statusin e ssaj të punës, andaj padia nuk ka mbështetje ligjore dhe si e tillë është e palejuar. Dispozita e nenit 46 paragrafi 2 i Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë përcaktohet se MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht në Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunitet e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenin 35 par.5,7,8 dhe 9 brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, paditësja nuk ka dëshmuar se është anëtare e sindikatës e paraparë me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1.1 të kontratës kolektive në arsim, poashtu edhe po të ishte anëtare e sindikatës, e që si anëtare të sindikatës apo vet SBASHK-u nuk ka asnjë angazhim të vetëm apo shkresë drejtuar Ministrisë së Financave për sigurimin e mjeteve brenda mundësive financiare, ashtu që për realizimin e kësaj të drejte lidhur me kompensimin për shpenzime të inflacionit në pagë nuk ekzistojnë mundësitë institucionale-financiare. Nga të lartcekurat e paditura ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si e pathemeltë kërkesëpadia e paditëses.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës gjyqësore dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës me nr. të protokollit Nr.137/3 i datës 02.10.2018 lëshuar nga e paditura për paditësen, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë Qendrës së Kompetencës në Prizren, si mësimdhënëse. Poashtu nga lista e pagave vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është shuma prej 459.00 euro.

Gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se "Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të

kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.07.2022 – 20.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 248.11 euro ( $459 * 11.6\% = 53.24 * 4$  muaj e 20 ditë = 248.11 euro).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 152 të LPK-së ku parashihet që “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”, ka vendosur si në pikën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (13.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, përkatësisht për precizimin e padisë meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtresë të deponuar në gjykatë

Numri i lëndës: 2023:257719

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06893867

e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar sipas aktvendimit për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**C.nr.4264/23, datë 11.02.2025**

**G j y q t a r i**

**Shaban Shala**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimin pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate